



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

-SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM-

Në bazë të nenit 7 të Vendimit për formimin e Këshillit për bashkëpunim me dhe zhvillim të sektorit civil ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 98/16 dhe 164/17 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 97/19 dhe 116/21), Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon

**RAPORT PËR ORGANIZATAT E PARAQITURA ME KANDIDATË dhe THIRRJE
PUBLIKE PËR VOTIM**
**për zgjedhjen e 5 anëtarëve të Këshillit për Bashkëpunim me dhe Zhvillim të Sektorit Civil nga
radhët e shoqatave dhe fondacioneve për fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, mediat dhe
shoqëria e informacionit, mbrojtja e mjedisit jetësor, sporti dhe integrimet dhe politikat e BE-së**

I. RAPORT PËR ORGANIZATAT E PARAQITURA ME KANDIDATË

Në bazë të Thirrjes Publike për zgjedhjen e 5 anëtarëve të Këshillit për Bashkëpunim me dhe Zhvillim të Sektorit Civil nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve për fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, mediat dhe shoqëria e informacionit, mbrojtja e mjedisit jetësor, sporti dhe integrimet dhe politikat e BE-së, publikuarmë 12 Maj të vitit 2021, në faqet e internetit www.nvosorabotka.gov.mk, në afatin e paraparë (26.5.2021) kanë arritur fletëparaqitje për 10 kandidatë.

Nuk është i plotë dokumentacioni i: Qendra për Afirmimin e Kulturës dhe Botimeve SHKUPI Shkup (nuk është dorëzuar ekzemplar i Gjendjes aktuale nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, Llogarisë përfundimtare për vitin 2020 Raport për punën me qëllimet, aktivitetet, rezultatet dhe burimet e financimit në tre vitet e fundit, Biografi dhe letër motivimi të kandidatit).

Gjatë verifikimit administrativ të fletëparaqitjeve u përcaktua se fletëparaqitjet e shoqatave dhe fondacioneve në vijim i plotësojnë kushtet e Thirrjes Publike: Shoqata e Qytetarëve Qendra për Zhvillim Bujqësor EKO Produkt Tetovë, Koalicioni Rural Kumanovë, Fondacioni për Afirmim dhe Prezantim Kulturor dhe Shkencor Maqedonia prezent Shkup, Shoqata për Inkurajim dhe Promovim të Informatikës Asocijacioni i Studentëve të Informatikës Shkup, Shoqata e Qytetarëve për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor EKOZVON Shkup, Shoqata Maqedonase për Bocija Shtip, Shoqata Organizata Multietnike për Kultura Ndërkombëtare Mozaik-Meik Shkup, Instituti për Kërkime dhe Analiza të Politikave Romalítico Shkup, Shoqata e Qytetarëve Forumi rinor për bashkëpunim Shkup.

II. THIRRJE PUBLIKE PËR VOTIM

për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për bashkëpunim me dhe zhvillim të sektorit civil nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve

Thirren të gjitha organizatat aktive të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet. të japin votën e tyre **vetëm për një kandidat, në fushën që është identike me fushën e veprimtë organizatës**, në përputhje me statutin e saj.

Organizatat nuk votojnë për kandidatin nga organizata e tyre.

Votimi kryhet duke plotësuar **Formularin e Votimit**, të disponueshëm në lidhjen vijuese www.nvosorabotka.gov.mk dhe duke dorëzuar ekzemplar të **gjendjes aktualenga** regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës.

Sindikatat e regjistruara në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet plotësojnë një formular votimi, që llogaritet për një votë të dhënë.

Organizatat mund të mbështesin vetëm një kandidat nga **Lista e Kandidatëve** në vijim.

Numri	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Emri i shoqatës/ fondacionit që propozon kandidat	Biografia dhe letër motivimi
11. Bujqësi dhe zhvillim rural			
32-40/7	Nesim Veliu	Shoqata e Qytetarëve Qendra për Zhvillim Bujqësor EKO Produkt Tetovë	
32-40/10	Liljana Jonoski	Koalicioni Rural Kumanovë	
13. Media dhe shoqëria informatike			
32-40/4	Hristo Petreski	Fondacioni për Afirimim dhe Prezantim Kulturor dhe Shkencor Maqedonia prezent Shkup	
32-40/8	Nikola Dodov	Shoqata për Inkurajim dhe Promovim të Informatikës Asocijacioni i Studentëve të Informatikës Shkup	
14. Mbrojtje e mjedisit jetësor			
32-40/2	Sllagjana Stamenkova	Shoqata e Qytetarëve për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor EKOZVON Shkup	
15. Sport			
32-40/3	Dejancho Zdravkov	Shoqata Maqedonase për Bocija Shtip	
32-40/11	Dragica Kostadinovska	Shoqata Organizata Multietnike për Kultura Ndërkombëtare Mozaik-Meik Shkup	
16. Politikat e BE-së dhe integrimet			
32-40/5	Marija Sulejmanova	Instituti për Kërkime dhe Analiza të Politikave Romalitico Shkup	

32-40/1	Oliver Romevski	Shoqata e Qytetarëve Forumi rinor për bashkëpunim Shkup	
---------	-----------------	---	--

Për vota të pavlefshme do të llogariten votat e organizatave që nuk janë **aktive** në përputhje me gjendjen aktuale nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, si dhe votat e organizatave që kanë votuar në fushën e veprimit që nuk është paraparë në statutin e tyre.

Organizatave që realizuan të drejtën e tyre për të votuar në periudhën prej 14 deri më 29.04.2021 dhe vota e tyre u konsiderua e vlefshme, nuk kanë të drejtë të votojnë përsëri.

Afati i votimit është deri më 21 Qershor 2021.

Formulari i plotësuar i votimit i nënshkruar nga përfaqësuesi i organizatës dhe i verifikuar me vulën e saj, me ekzemplar të **gjendjes aktuale** nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, duhet të dorëzohen përmes postës në adresën:

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sekretariati i Përgjithshëm
Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare
bul. "Ilinden" nr.2
1000 Shkup

me shënimin: "Mbështetje për kandidat për anëtar të Këshillit".
ose **të skanuara** të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën: nvosorabotka@gs.gov.mk.

Në afat prej 8 ditëve pas përfundimit të votimit, Sekretariati i Përgjithshëm - Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në faqen e internetit www.nvosorabotka.gov.mk do të publikojë Listën e kandidatëve sipas numrit të votave të marra për secilën nga fushat e veprimit.

Nëse për ndonjë nga fushat e veprimit nuk paraqiten kandidatë ose asnjëri nga kandidatët e paraqitur nuk i plotëson kushtet e përcaktuara, përsëro do të përcaktohet thirrje publike për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve, vetëm për atë fushë të veprimit.

Në rast kur ka dy ose më shumë kandidatë të renditur në radhë të parë, votimi do të përsëritet vetëm në atë fushë më së voni 15 ditë nga publikimi i Listës së Kandidatëve.